



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 16.02.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN “LINJA E
TRANSMETIMIT 110 KV UZNOVË - ÇOROVODË”, NË TERRITORIN E QARKUT
BERAT

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për projektin “Linja e transmetimit 110 kv Uznovë – Çorovodë”, në territorin e Qarkut Berat dhe subjekt kërkues shoqërinë “OST” sh.a.
2. Bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi Harta e Planvendosjes së Linjës.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësisë së Qeverisjes Vendore ku shtrihet Linja.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARIA

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Z. DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ENERGIJË DHE INDUSTRIJË



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT